



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 226/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.04.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Kërkesë për propozime*” me Nr. REF-47446-02-13-2018, me objekt: “*Shërbim interneti dhe telefoni*”, me fond limit 1 280 000 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 26.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Ankimues: “Albtelecom” sha
Autostrada Tiranë Durrës, Km. 7, Kashar

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Fier
Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi” Fier

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.02.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Kërkesë për propozime*” me Nr. REF-47446-02-13-2018, me objekt : “*Shërbim interneti dhe telefoni*”, me fond limit 1 280 000 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 26.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 16.02.2018, operatori ekonomik ankimues “Albtelecom” sh.a., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...] Më datën 14.02.2018 në sistemin e APP-së nga autoriteti kontraktor Bashkia Fier është shpallur procedura me objektin e mësipërm. Në kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.3.3.4 kërkohet: Afati i lidhjes së shërbimit të internetit dhe telefonit do të jetë brenda 24 oreve nga nenshkrimi i kontrates. Në specifikimet teknike për shërbimin e telefonisë pika 10 kërkohet: Afati i lëvrimit të shërbimit do të jetë brenda 24 oreve nga nenshkrimi i kontrates dhe për gjithë periudhën e prokurimit duke filluar nga data e lidhjes së kontratës. Në shtojcën 10 “*Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit*” pika 1 gjithashtu kërkohen: Afati i lidhjes së shërbimit të internetit dhe telefonit do të jetë brenda 24 oreve nga nenshkrimi i kontrates. Në pikën 13 të specifikimeve teknike për shërbimin e telefonisë kërkohet:

Numrat e telefonit fiks që do të përfitojë Autoriteti Kontraktor janë:

NR	Numri i Telefonit
1	034 410 638
2	034 410 636
3	034 410 635
4	034 410 617
5	034 410 616
6	034 410 612
7	034 410 622
8	034 410 620
9	034 410 646
10	034 410 647

Albtelecom sha i konsideron kërkesat e mësipërme si diskriminuese për këto arsye:

Kërkesa për lidhjen e shërbimit brenda 24 orëve nuk është një kërkesë e arsyeshme duke qënë se AK-ja kërkon në të njëjtën kohë që të mbajë të njëjtët numra që janë të oe-së që e ofron shërbimin aktualisht. Në rregulloren e portabilitetit të miratuar nga AKEP specifikohet që operatori dhënës mund të refuzoj portimin e numrave nëse klienti ka detyrime. Kjo do të bënte të pamundur lidhjen e shërbimit brenda afatit të kërkuar prej 24 orësh. Duke qënë se sipas shtojcës 8 shërbimi i internetit dhe telefonisë kërkohet në 18 pika të ndryshme, në njërën nga këto pika (pika 18) me vendndodhje të papërcaktuar lidhja e shërbimit brenda 24 orëve është një kërkesë jo e arsyeshme dhe proporcionale me objektin që prokurohet.

Përsa më sipër “Albtelekom” sha kërkon nga AK-ja rishikimin e afatit prej 24 orësh për lidhjen e shërbimit në një afat prej 7 ditësh.

2. Në shtojcën 8 specifikimet teknike pika 1 kërkohet : “Linja parësore dhe cdo pikë lidhjeje të jëtë me fibër optike. Albtelecom sha e konsideron kërkesën e mësipërme si të paarsyeshme dhe jo proporcionale me objektin e prokurimit për arsyet e mëposhtme:

Fibra optike është një nga teknologjitë me të cilat mundt të ofrohet shërbimi që kërkohet nga autoriteti kontraktor. Si e tillë kërkesa për të ofruar këtë shërbim vetëm me fibër optike është një kriter kufizues. Vetëm në pikën 1 Bashkia Fier (Zyrat Qëndrore) kapaciteti i kërkuar 50Mbps/50Mbps, justifikon kërkesën pqr fiber optike duke qënë se nuk mund të jepet me teknologji tjetër. Për të gjitha pikat e tjera kapacitetet e kërkuara mund të jepen edhe me teknologji të tjera duke mos kufizuar mundësinë për

operatorët ekonomikë. Përsa më sipër Altelecom sha kërkon nga AK-ja të rishikojë këtë kërkesë dhe të përfshijë mundësinë e ofrimit të shërbimit me teknologji të tjera ekuivalente. Në shtocën 8 “Specifikimet teknike” pika 3 kërkohet “pajisje fundore Router Mikrotik RB 951” Altelecom e konsideron kërkesën e mësipërme si kufizuese dhe diskriminuese duke qënë se si në LPP-së edhe në VKM-në 941 por edhe në dst të kësaj procedure (faqe) 30 thuhet shprehimisht “Aspecifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër i vecantë Mikrotik RB 951 është referencë e qartë ndaj një marke të caktuar dhe një produkti të vecantë . Përsa më sipër Altelecom kërkon heqjen e referencës ndaj produktit dhe markës së vecantë dhe /ose parashikimin e produkteve dhe markave ekuivalente.

II.3. Në datën 26.02.2018, nëpërmjet shkresës nr. 1774/4 prot., datë 21.02.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes, duke e pranuar pjesërisht ankesën e paraqitur, me argumentimin si më poshtë vijon:

[...]

Të pranojë pjesërisht ankesën tuaj me argumentimin si më poshtë:

Në kriteret e vecanta të kualifikimit të dst-ve ndërmjet të tjerash është kërkuar:

2.3. Kapaciteti teknik

Operatori duhet të jetë i licencuar në shërbimin për transmetimin e të dhënave dhe të plotësojë pikat si më poshtë:

4. Afati i lidhjes së shërbimit të internetit dhe telefonit do të jetë brenda 24 orëve nga nënshkrimi i kontratës.

Operatori ekonomik “Altelecom” sha në përfundim të argumentimit të paraqitur për pikat e mësipërme ka kërkuar rishikimin e afatit prej 24 orësh për lidhjen e shërbimit në një afat prej 7 ditësh pasi shërbimi telefonik për numrat e kërkuar mund të refuzohet nga operatori dhënës për shkak të detyrimeve dhe bëhet e pamundur lidhja e shërbimit të kërkuar brenda afatit 24 orësh, bazuar dhe në faktin se operatori ekonomik do të mbajë të njëjtat numra telefoni që disponon aktualisht.

Gjithashtu bazuar në faktin që shërbimi i internetit dhe telefonit kërkohet në pika të ndryshme lidhja e shërbimit brenda 24 orësh është një kërkesë jo e arsyeshme dhe jo proporcionale me objektin që prokurohet. VKM nr. 914 datë 29.12.2014 neni 46[...].

Në kuadër të përcaktimeve të LPP-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij KSHA-ja mendon se afati i lëvrimit prej 24 orë i përcaktuar në specifikimet teknike dhe i vendosur në këtë procedurë prokurimit është i pamjaftueshëm për lidhjen e shërbimit përfshirë të gjitha proceset që kërkon lidhja e këtij shërbimi. Operatorit duhet ti vihet në dispozicion një afat prej 5 ditësh në mënyrë që të ketë të gjithë kohën e mjaftueshme për të realizuar shërbimin brenda parametrave të kërkuara.

KSHA-ja pasi diskutoi dhe me Njësinë e Prokurimit mendon që ankesa e operatorit ekonomik për këtë pikë është pjesërisht e drejtë dhe vendosi që kjo pikë duhet të ndryshohet si më poshtë:

2.3.3 Operatori duhet të jetë i licencuar në shërbimin për transmetimin e të dhënave dhe të plotësojë pikat si më poshtë:

4. Afati i lidhjes së shërbimit të internetit dhe telefonit do të jetë brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Ky ndryshim do të pasqyrohet në shtojcën që do të hartohet nga ana e Njësisë së Prokurimit dhe do të hidhet në sistem për të gjithë oe-të të interesuar për këtë procedurë.

Pretendimi i oe-së për ndryshimin e kësaj pike qëndron dhe është pjesërisht i drejtë.

2. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” ndërmjet të tjerash është kërkuar:

Specifikimet teknike për shërbimin e internetit:

Linjë parësore për cdo pikë lidhjeje të jetë me fibër optike.

KSHA-ja për shqyrtimin e ankesë në radhë të parë iu referua LPP-së konkretisht neni 46[...].

Gjithashtu VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 [...]

Specifikat e shërbimit të kërkuar janë hartuar nga specialist të përkatës dhe është e drejtë e AK-së të kërkojë që shërbimi të jetë sa më cilësor për të duke përcaktuar dhe mënyrat më bashkëkohore të ofrimit të tij brenda hapsirave që i lejon ligji. Plotësimi i kriterit të kërkuar në specifikime teknike prej oe-ve pjesmarrës do të krijojë besueshmëri seriozitet kapacitet dhe mbi të gjithë demonstron aftësinë e oe-së për të realizuar me sukse dhe me cilësinë e kërkuar kontratën që prokurohet.

Është e drejtë e AK-së që për realizimin e kërkesve të kësaj kontrate, të vendosë specifikime që i përgjigjen cilësisë më të mirë të ofrimit të shërbimit që kërkohet, me qëllim plotësimin e aftësive teknike, profesionale dhe ekonomike prej operatorëve pjesmarrës të mundshëm në këtë procedurë. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron dhe komisioni mendon se ky specifikim i kërkuar në shtojcën nr. 8 është i drejtë.

3. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” ndërmjet të tjerash është kërkuar:

Specifikimet teknike për shërbimin e internetit:

3. Pajisje fundore Router Microtik RB 951. [...]

Në kuadër të përcaktimeve të LPP-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij KSHA –ja mendon bazuar në faktin se pajisja fundore Router Microtik Rb 951 është emër marke e caktuar, vendosi heqjen e referencës së produktit dhe parashikimin e produkteve dhe markave ekuivalente duke bërë ndryshimin si më poshtë:

Specifikimet teknike për shërbimin e internetit:

3. Pajisje fundore Router Microtik RB 951 ose markë ekuivalente me të.

Ky ndryshim do të pasqyrohet në shtojcën që do të hartohet nga njësi e prokurimit dhe do të hidhet në sistem për të gjithë oe-të e interesuar për këtë procedurë.

Pretendimi i Oe-së për ndryshimin e kësaj pike qëndron dhe është i drejtë.

Për këtë arsye në përfundim të shqyrtimit të ankesës tuaj në lidhje me kriteret e vecanta të kualifikimit Autoriteti Kontraktor konstaton se ato qëndrojnë pjesërisht dhe bazuar në argumentimin e mësipërm ankesa pranohet pjesërisht.

II.4. Në datën 28.02.2018 operatori ekonomik “Albtelecom” sha ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kërkuar modifikimin e dokumentave me argumentat si më poshtë vijon:

[...] Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” pika 1 kërkohet “Linja parësore dhe cdo pikë lidhje të jetë me fibër optike”.

“Albtelecom” sha e konsideron kërkesën e mësipërme sit ë parasyeshme dhe jo proporcionale me objektin e prokurimit për arsyet e mëposhtme:

- a. Fibra optike është vetëm një nga teknologjitë me të cilat mund të ofrohet shërbimi që kërkohet nga AK-ja . Si e tillë kërkesa për të ofruar këtë shërbim vetëm me fibër optike është një kriter kufizues.*
- b. Vetëm për pikën 1 “Bashkia Fier” (Zyra Qëndrore) kapaciteti i kërkuar 50Mbps/50Mbps, justifikon kërkesën për fibër optike , duke qënë se nuk mund të jepet me teknologji tjetër. Për të*

gjitha pikat e tjera kapacitet e kërkuara mund të jepen edhe me teknologji të tjera duke mos kufizuar mundësitë për operatorët ekonomikë.

- c. Albtelecom ofron cilësi shërbimi duke garantuar nivelet e SLA në përputhje me nivelet e kërkuara. Cilësia e shërbimit nuk kufizohet nga teknologjia e Fibrës optike. Kapaciteti i kërkuar mund të ofrohet me disa teknologji alternative, duke ju përmbajtur kushteve të cilësisë së shërbimit.*
- d. Kapaciteti 8 Mbps/2Mbps, i kërkuar për njësitë, mund të ofrohet me teknologji alternative si VSDL ose antenë duke plotësuar të gjitha kushtet si: stabilitet, kohë komunikimi të ulët (PING), CIR 99.9%, JITTER në nivele minimale. Përsa më sipër Albtelecom sha kërkon nga autoriteti kontraktor të rishikojë këtë kërkesë dhe të përfshijë mundësinë e ofrimit të shërbimit me teknologji të tjera ekuivalente.*

II.5. Në datën 09.03.2018, nëpërmjet shkresës nr. 2302/1prot., datë 07.03.2018, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Albtelecom” sha për modifikimin e kriterit “[...] Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” pika 1 kërkohet “Linja parësore dhe cdo pikë lidhje të jetë me fibër optike”.

“Albtelecom” sha e konsideron kërkesën e mësipërme sit ë parasyeshme dhe jo proporcionale me objektin e prokurimit për arsytet e mëposhtme: Fibra optike është vetëm një nga teknologjitë me të cilat mund të ofrohet shërbimi që kërkohet nga AK-ja . Si e tillë kërkesa për të ofruar këtë shërbim vetëm me fibër optike është një kriter kufizues. Vetëm për pikën 1 “Bashkia Fier” (Zyra Qëndrore) kapaciteti i kërkuar 50Mbps/50Mbps, justifikon kërkesën për fibër optike , duke qënë se nuk mund të jepet me teknologji tjetër. Për të gjitha pikat e tjera kapacitet e kërkuara mund të jepen edhe me teknologji të tjera duke mos kufizuar mundësitë për operatorët ekonomikë. Albtelecom ofron cilësi shërbimi duke garantuar nivelet e SLA në përputhje me nivelet e kërkuara. Cilësia e shërbimit nuk kufizohet nga teknologjia e Fibrës optike. Kapaciteti i kërkuar mund të ofrohet me disa teknologji alternative, duke ju përmbajtur kushteve të cilësisë së shërbimit. Kapaciteti 8 Mbps/2Mbps, i kërkuar për njësitë, mund të ofrohet me teknologji alternative si VSDL ose antenë duke plotësuar të gjitha kushtet si: stabilitet, kohë komunikimi të ulët (PING), CIR 99.9%, JITTER në nivele minimale. Përsa më sipër Albtelecom sha kërkon nga autoriteti kontraktor të rishikojë këtë kërkesë dhe të përfshijë mundësinë e ofrimit të shërbimit me teknologji të tjera ekuivalente.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, “Specifikimet teknike”, pika 1 është përcaktuar kriteri si më poshtë:

Specifikimet teknike për shërbimin e internetit:

Bazuar në VKB nr. 97 datë 19.12.2017 “Për miratimin e Buxhetit për vitin 2018”, në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2018, si dhe te urdhërit nr.78 më datë 09/02/2018, me nr.1493 prot., “Mbi llogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit ‘Shërbim internet dhe telefoni’” kërkojmë:

Të realizohet procedura në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas kërkesave dhe specifikimeve të mëposhtme si dhe duke ju referuar kërkesave dhe standarteve për shërbimin e internetit kërkojmë nga Operatori:

1. Linja parësore për cdo pike lidhje të jëtë me fiber optike.

2. Linja Back up të siguroje ½ e shërbimit dhe të jëtë e instaluar me Link Point-to-point.

3. Pajisje fundore Router Mikrotik RB 951.

(Për zyrat Qëndrore të Bashkisë kërkojmë që cdo lidhje të ketë pajisje tip mikrotikpra

2 Pajisje Mikrotik për konfigurime të ndryshme sipas nevojave të institucionit).

4. Operatori duhet të sigurojë Bllok me IP Statike.

5. Të sigurojë Instalimin e rrjetit deri në pikën shpërndarëse të LAN (Rack-un qëndror) dhe vendosjen /konfigurimin e pajisjeve për ofrimin e këtij shërbimi.

6. Kërkojmë shërbimin e internetit në përputhje me specifikimet dhe ky shërbim të shtrihet edhe në institucionet në varesi të Bashkisë sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela me Emertimet e institucioneve që do përfitojnë shërbim Interneti:

NR	Emertimi i Institucionit	Nr. Lidhjeve	Specifikimet Teknike
1	Bashkia Fier (Zyrat Qendrore)	2 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)	Lidhja 1 Doënlload/Upload :50Mbps/50Mbps , IP reale:Bllok IP Statike, Menyra e lidhjes: Fiber Optike; Dedikuar :full (e plote); TrafikuMujor: Pa limit

			<p>Suppotr:SLA 3</p> <p>Lidhja 2</p> <p>Doënload/Upload :50Mbps/50Mbps ,</p> <p>IP reale:Bllok IP Statike,</p> <p>Menyra e lidhjes: Fiber Optike;</p> <p>Dedikuar :full (e plote);</p> <p>TrafikuMujor: Pa limit</p> <p>Suppotr:SLA 3</p>
2	<p>Njësia Administrative</p> <p>NR 1 dhe NR 4</p> <p>Rajonet (R1, R4)</p>	<p>1 lidhje</p> <p>(sipas Specifikimeve Teknike)</p>	<p>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit)</p> <p>Menyra e lidhjes: F.O;</p> <p>Dedikuar: full</p> <p>TrafikMujor : Pa limit</p> <p>Support:SLA 3</p>
3	<p>Njësia Administrative</p> <p>NR 2 dhe NR 3</p> <p>Rajonet (R2, R3)</p>	<p>1 lidhje</p> <p>(sipas Specifikimeve Teknike)</p>	<p>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit)</p> <p>Menyra e lidhjes: F.O;</p> <p>Dedikuar: full</p> <p>TrafikMujor : Pa limit</p> <p>Support:SLA 3</p>
4	<p>Njesia Administrative Qender</p>	<p>1 lidhje</p> <p>(sipas Specifikimeve Teknike)</p>	<p>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit)</p> <p>Menyra e lidhjes: F.O;</p> <p>Dedikuar: full</p> <p>TrafikMujor : Pa limit</p> <p>Support:SLA 3</p>

5	<i>Njesia Administrative Dermenas</i>	<i>1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)</i>	<i>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3</i>
6	<i>Njesia Administrative Topoje</i>	<i>1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)</i>	<i>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3</i>
7	<i>Njesia Administrative Mbrostar</i>	<i>1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)</i>	<i>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3</i>
8	<i>Njesia Administrative Libofsh</i>	<i>1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)</i>	<i>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3</i>
9	<i>Njesia Administrative Portez</i>	<i>1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)</i>	<i>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3</i>

10	Njesia Administrative Levan	1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)	Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3
11	Njesia Administrative Frakull	1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)	Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3
12	Njesia Administrative Cakran	1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)	Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Mënyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3
13	Qendra PAK	1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)	Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Mënyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3
14	Emergjencat Civile	1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)	Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Mënyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit

			<i>Support:SLA 3</i>
15	<i>Drejtoria e Shërbimit Buqësor dhe Veterinar</i>	<i>1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)</i>	<i>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3</i>
16	<i>Drejtoria e Turizmit</i>	<i>1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)</i>	<i>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3</i>
17	<i>INUV</i>	<i>1 lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)</i>	<i>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3</i>
18	<i>INFO KIOSKAT (Vendodhja e pa përcaktuar, por mendohet te jene Brenda unazes se madhe të qytetit)</i>	<i>4 (kater) lidhje (sipas Specifikimeve Teknike)</i>	<i>Doënload/Upload : 8Mbps/2Mbps (pa limit) Menyra e lidhjes: F.O; Dedikuar: full TrafikMujor : Pa limit Support:SLA 3</i>

KARAKTERISTIKAT QE DUHET TE PLOTËSOJË OPERATORI:

1. Të këtë me shumë se 10 vjete eksperience .

2. Të jetë i licencuar nga AKEP për:
3. Shërbim interneti .
4. Shërbim i transmetimit të të dhënave
5. Të ketë përfaqesues në Fier.
6. Të sigurojë Instalimin e rrjetit deri në pikën shpërndarëse të LAN (Rack-un qëndror sipas kërkesave të institucioneve përkatese) dhe vendosjen / konfigurimin e pajisjeve për ofrimin e këtij shërbimi.
7. Të garantojë shërbimin e internetit 24 ore në 7 ditë, për periudhën e vlefshmerisë së kontratës.
8. Mbështetje teknike për problemet që kanë lidhje me shërbimet e ofruara në përputhje me Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit (SLA 3)
9. Në rastin e ndërprerjes së shërbimit, koha e zgjidhjes së problemit te jete Brenda 3 oresh. Ky afat nuk përfshin kohën e transportit, pengesat e forcave madhore, defektet e përgjithshme në rrjet dhe vonesat e shkaktuara nga përdoruesi.
10. Koha maksimale gjatë së cilës do të kryhet përcaktimi i problemit do të vendoset afati i përafërt i zgjidhjes së tij duhet të jetë Brenda 9 minutash
11. Shërbimi i Internetit duhet të ofrohet i dedikuar (jo shared) dhe pa kufizim, trafikui Interneti në Doëload dhe Upload(D/U), për cdo intitucion sipas përcaktimeve në tabelen e mësipërme.
12. Operatori duhet të garantojë qëndrueshmërinë /vazhdueshmërin e shërbimit dhe detyrimisht në rastet e defekteve të ndryshme elektrike duhet të përdori UPS ose Gjenerator.

Specifikimet teknike per sherbimin e telefonisë:

Bazuar në VKB nr. 97 datë 19.12.2017 “Për miratimin e Buxhetit për vitin 2018”, në Regjistrin e Parashikimit të Prokurimeve Publike për vitin 2018, si dhe te urdhërit nr.78 më datë 09/02/2018, me nr.1493 prot., “Mbi llogaritjen e fondit limit për objektin e prokurimit ‘Shërbim internet dhe telefoni’” kërkojmë:

1. Të bëhen procedurat në përputhje me legjislacionin në fuqi sipas kërkesës së specifikuar më poshtë:

Nr.	Emërtimi i shërbimit	specifikimi
1	Sasia e numrave/vjetore	10 numra
2	Menyra e lidhjes	IP
3	Nderfaqja e telefonise	Analoge FXS

Central telefonie IP me 10 numra.

1. *Mundësi komunikimi me numra të brendshëm me 3 shifra dhe më mundësi sim karte.*
2. *Biseda telefonike brenda rrjetit të operatorit.*
3. *Biseda telefonike drejt të gjithë nr. Celular brenda Shqipërisë.*
4. *Biseda telefonike ndërkombëtare.*
5. *Server i brendshëm dhe menaxhimi i centralit.*
6. *UPS APC 750 për qëndrueshmërinë e centralit.*
7. *Konfigurim dhe mirembajtje e centralit për thirrje me numrat e grupit.*
8. *Instalim dhe konfigurim i rrjetit të brendshëm të telefonisë;*

- *Sekrearia telefonike,*
- *Identifikimi i thirrjes,*
- *Transferimi i thirrjes,*
- *Tarifimi për sekondë,*
- *Kontrolli i historikut,*
- *Kontrolli on line i konsumit,*
- *Çmimi për minuta Mix jo më i lartë se 8 lekë/minute.*

9. *Kompania duhet të ketë të paktën 7 vjet eksperience në fushën e telekomunikacioneve.*
10. *Afati i lëvrimit të shërbimit do të jetë brenda 24 oreve nga nënshkrimi i kontrates dhe për gjithë periudhen e prokurimit duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.*
11. *Ofertuesi duhet të zbatojë dhe realizojë sigurinë e shërbimit.*
12. *Ofertuesi duhet të sigurojë mbështetje teknike për problemet që kanë lidhje me shërbimin e ofruar në përputhje me Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit (SLA3) .*
13. *Kontraktuesi duhet të pajisë Autoritetin Kontraktor me numra telefoni, Brenda hapësirës numerike të vëne në dispozicion nga Autoriteti Elektronike dhe Postar. Numrat e telefonit fiks që do të përfitojë Autoriteti Kontraktor janë:*

<i>NR</i>	<i>Numri i Telefonit</i>
<i>1</i>	<i>034 410 638</i>
<i>2</i>	<i>034 410 636</i>
<i>3</i>	<i>034 410 635</i>
<i>4</i>	<i>034 410 617</i>
<i>5</i>	<i>034 410 616</i>

6	034 410 612
7	034 410 622
8	034 410 620
9	034 410 646
10	034 410 647

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

III.1.3. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:[...] 2. Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” ndërmjet të tjerash është kërkuar:

Specifikimet teknike për shërbimin e internetit:

Linjë parësore për cdo pikë lidhjeje të jetë me fibër optike.

KSHA-ja për shqyrtimin e ankesës në radhë të parë iu referua LPP-së konkretisht neni 46[...].

Gjithashtu VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 [...]

Specifikat e shërbimit të kërkuar janë hartuar nga specialist përkatës dhe është e drejtë e AK-së të kërkojë që shërbimi të jetë sa më cilësor për të, duke përcaktuar dhe mënyrat më bashkëkohore të ofrimit të tij brenda hapsirave që i lejon ligji. Plotësimi i kriterit të kërkuar në specifikime teknike prej oe-ve pjesmarrës do të krijojë besueshmëri seriozitet kapacitet dhe mbi të gjithë demonstron aftësinë e oe-së për të realizuar me sukse dhe me cilësinë e kërkuar kontratën që prokurohet.

Është e drejtë e AK-së që për realizimin e kërkesve të kësaj kontrate, të vendosë specifikime që i përgjigjen cilësisë më të mirë të ofrimit të shërbimit që kërkohet, me qëllim plotësimin e aftësive teknike, profesionale dhe ekonomike prej operatorëve pjesmarrës të mundshëm në këtë procedurë. Për këtë arsye pretendimi juaj nuk qëndron dhe komisioni mendon se ky specifikim i kërkuar në shtojcën nr. 8 është i drejtë.[...]

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, geramat “a” e “b” e ligjit nr. 9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative,

reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.5. Në nenin 28 pika 2 *“Kontratat shërbimeve”* të VKM nr.914 dt.29.12.2014 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar parashikohet *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

Në nenin 28, pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në”[...].*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.1.7. Referuar objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, termave të referencës si dhe shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit të parashikuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se ofrimi nga ana e operatorëve ekonomikë vetëm me një nga teknologjitë me të cilat mund të ofrohet shërbimi konkretisht në shtojcën 8 *“Specifikimet teknike” “Linja parësore dhe çdo pikë lidhje të jetë me fibër optike”*, me përjashtim të pikës 1 *“Bashkia Fier” (Zyra Qëndrore)*, si e tillë nuk duhet të jenë kufizuese dhe përcaktuese drejt një teknologjie të vetme e cila kufizon pjesëmarrjen e shoqërive në këtë procedurë prokurimi”. Në këtë kuptim Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e kriterit të sipërcituar në lidhje me teknologjinë *“fibër optike”* për çdo pikë lidhje me përjashtim të pikës 1 *“Bashkia Fier” (Zyra Qëndrore)*,

për vet faktin, se dhe kapaciteti i kërkuar për këtë pikë Download/Upload: 50Mbps/50Mbps, justifikon kërkesën për fibër optike, ndërsa të gjitha pikat e tjera të parashikuara më sipër nga autoriteti kontraktor referuar dhe kapacitetit të kërkuar: konkretisht Download/Upload: 8Mbps/2Mbps (pa limit) mund të jepen me teknologji të tjera, duke referuar Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

[...]

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron, ndaj autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimet përkatëse duke hequr mundësinë e ofrimit të këtij shërbimi vetëm me fibër optike “[...]për të gjitha pikat e tjera [...]” për të mos kufizuar konkurrencën dhe diskriminuar operatorët ekonomikë të interesuar për procedurën e prokurimit.

III.2. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të autoritetit kontraktor, mbi provueshmërinë e “Afati i lëvrimin të shërbimit do të jetë brenda 24 orëve nga nënshkrimi i kontratës dhe për gjithë periudhën e prokurimit duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.” si dhe në lidhje me pikën e specifikimeve teknike se “Në shtocën 8 “Specifikimet teknike” pika 3 kërkohet “pajisje fundore Router Mikrotik RB 951” Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se: referuar kthim përgjigjes së autoritetit kontraktor lidhur me këtë pikë të ankesës sqarohet se “[...] Në kriteret e vecanta të kualifikimit të dst-ve ndërmjet të tjerash është kërkuar:

2.3. Kapaciteti teknik

Operatori duhet të jetë i licencuar në shërbimin për transmetimin e të dhënave dhe të plotësojë pikat si më poshtë:

4. Afati i lidhjes së shërbimit të internetit dhe telefonit do të jetë brenda 24 orëve nga nënshkrimi i kontratës.

Operatori ekonomik “Albtelecom” sha në përfundim të argumentimit të paraqitur për pikat e mësipërme ka kërkuar rishikimin e afatit prej 24 orësh për lidhjen e shërbimit në një afat prej 7 ditësh pasi shërbimi telefonik për numrat e kërkuar mund të refuzohet nga operatori dhënës për shkak të detyrimeve dhe bëhet e pamundur lidhja e shërbimit të kërkuar brenda afatit 24 orësh, bazuar dhe në faktin se operatori ekonomik do të mbajë të njëjtat numra telefoni që disponon aktualisht.

Gjithashtu bazyuar në faktin që shërbimi i internetit dhe telefonit kërkohet në pika të ndryshme lidhja e shërbimit brenda 24 orësh është një kërkesë jo e arsyeshme dhe jo proporcionale me objektin që prokurohet. VKM nr. 914 datë 29.12.2014 neni 46[...].

Në kuadër të përcaktimeve të LPP-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij KSHA-ja mendon se afati i lëvrimin prej 24 orë i përcaktuar në specifikimet teknike dhe i vendosur në këtë procedurë prokurimit është i pamjaftueshëm për lidhjen e shërbimit përfshirë të gjitha proceset që krkon lidhja e këtij shërbimi. Operatorit duhet ti vihet në dispozicion një afat prej 5 ditësh në mënyrë që të ketë të gjithë kohën e mjaftueshme për të realizuar shërbimin brenda parametrave të kërkuara.

KSHA-ja pasi diskutoi dhe me Njësinë e Prokurimit mendon që ankesa e operatorit ekonomik për këtë pikë është pjesërisht e drejtë dhe vendosi që kjo pikë duhet të ndryshohet si më poshtë:

2.3.3 Operatori duhet të jetë i licencuar në shërbimin për transmetimin e të dhënave dhe të plotësojë pika si më poshtë:

4. Afati i lidhjes së shërbimit të internetit dhe telefonit do të jetë brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Ky ndryshim do të pasqyrohet në shtojcën që do të hartohet nga ana e Njësisë së Prokurimit dhe do të hidhet në sistem për të gjithë oe-të të interesuar për këtë procedurë.

Pretendimi i oe-së për ndryshimin e kësaj pike qëndron dhe është pjesërisht i drejtë.[...] Në shtojcën 8 “Specifikimet teknike” ndërmjet të tjerash është kërkuar:

Specifikimet teknike për shërbimin e internetit:

3. Pajisje fundore Router Microtik RB 951. [...]

Në kuadër të përcaktimeve të LPP-së dhe akteve nënligjore në zbatim të tij KSHA –ja mendon bazuar në faktin se pajisja fundore Router Microtik Rb 951 është emër marke e caktuar, vendosi heqjen e referencës së produktit dhe parashikimin e produkteve dhe markave ekuivalente duke bërë ndryshimin si më poshtë:

Specifikimet teknike për shërbimin e internetit:

3. Pajisje fundore Router Microtik RB 951 ose markë ekuivalente me të.

Ky ndryshim do të pasqyrohet në shtojcën që do të hartohet nga njësia e prokurimit dhe do të hidhet në sistem për të gjithë oe-të e interesuar për këtë procedurë.

Pretendimi i Oe-së për ndryshimin e kësaj pike qëndron dhe është i drejtë.

Ankimuesi është sqaruar për këto dy pika të ankesës nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të bëjë publikimin e sqarimeve përkatëse në SPE në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]* Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga njëoperator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albtelecom” sha për procedurën e prokurimit prokurimit “Kërkesë për propozime” me Nr. REF-47446-02-13-2018, me objekt : “Shërbim interneti dhe telefoni”, me fond limit 1 280 000 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar më datë 26.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albtelecom” sha
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 380 Protokolli, Datë 28.02.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

